



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

NR. 1 REGJ. THEM.

DATË 07.06.2021 REGJ.

NR. 1 VENDIMI

DATË 08.06.2021 VENDIMI

V E N D I M

“Për shqyrtimin e kërkesës për përjashtim gjyqtari”

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, i përbërë nga :

GJYQTARE : Edlira PETRI
GJYQTAR : Gentjan MEDJA
GJYQTARE : Manjola XHAXHO
GJYQTAR : Asim VOKSHI
GJYQTARE : Alma KOLGJOKA
GJYQTARE : Esmeralda ÇEKA (XHILI)
GJYQTAR : Sokol IBI
GJYQTARE : Emona MUÇI

asistuar nga sekretare gjyqësore Ermelinda Nuraj, në datë 08.06.2021, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, kërkesën nr. 1 regjistri themeltar, datë 07.06.2021 që i përket:

KËRKUES :Subjekti Zgjedhor, Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim” (PD – AN)

OBJEKTI : Përjashtimi nga gjykimi i padive të paraqitura nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim i shtatë gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor.

BAZA LIGJORE : Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Nenet 151 dhe 156 të Kodit Zgjedhor; Nenet 72 dhe 74 të Kodit të Procedurës Civile.

KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR

pasi administroi kërkesën dhe diskutoi mbi shkaqet e parashtruara për përjashtimin e gjyqtarëve

VËREN:

FAKTET E ÇËSHTJES:

Me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, Presidenti i Republikës ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92 shkronja “gj” dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

Në datë 08.09.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor organizoi shortin për përzgjedhjen e gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, mes gjyqtarëve që kishin kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, konform përcaktimeve të nenit 146 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar. Në përfundim të procedurës publike u përzgjedhën tetë gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor gjyqtarët : Znj. Manjola Xhaxho, Z. Gentjan Medja, Z. Sokol Ibi, Znj. Alma Kolgjoka, Znj. Emona Muci, Znj. Esmeralda Xhili (Ceka), Z. Asim Vokshi dhe Znj. Edlira Petri.

Në datë 10.09.2020, gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor kryen betimin në një ceremoni publike të organizuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Bazuar në vendimin nr. 2, datë 26.02.2021 “Për thirrjen në detyrë të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.04.2021”, në datë 05.03.2021 u organizua pranë KLGJ-së, takimi për thirrjen në detyrë të gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.

Në ushtrim të kompetencave të caktuara me ligj, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor shqyrtoi të gjitha mosmarrëveshjet parazgjedhore, që u referuan në selinë e tij, Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Pas përfundimit të procesit të votimit, pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor u paraqitën

njësëre ankimesh të subjekteve zgjedhore. Mbi këtë bazë, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor shqyrtoi mosmarrëveshjet zgjedhore dhe dha këto vendime përfundimtare :

- (i) Vendimi nr. 9, datë 31.05.2021, me të cilin u rrëzuan paditë e subjekteve zgjedhore Kreshnik Merxhani, Partia “Lëvizja Socialiste për Integrim” dhe Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim” (PD – AN), për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Ankimeve të Sanksioneve nr. 86, datë 19.05.2021, lidhur me zgjedhjet në Qarkun Gjirokastrë.
- (ii) Vendimi nr. 10, datë 01.06.2021, me të cilin u rrëzuan paditë e subjekteve zgjedhore Partia “Lëvizja Socialiste për Integrim” dhe Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim” (PD – AN), për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Ankimeve të Sanksioneve nr. 87, datë 20.05.2021, lidhur me zgjedhjet në Qarkun Vlorë.
- (iii) Vendimi nr. 11, datë 04.06.2021, me të cilin u rrëzuan paditë e subjekteve zgjedhore Partia “Lëvizja Socialiste për Integrim” dhe Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim” (PD – AN), për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Ankimeve të Sanksioneve nr. 88, datë 21.05.2021, lidhur me zgjedhjet në Qarkun Berat.

Veç sa më sipër, sikurse është njoftuar edhe publikisht në faqen zyrtare elektronike të Gjykatës Administrative të Apelit, është hedhur shorti për caktimin e trupave gjykues dhe është caktuar data e seancës gjyqësore lidhur me ankimet zgjedhore ndaj vendimeve : nr. 89, datë 25.05.2021 (për qarkun Shkodër); nr. 90, datë 26.05.2021 (për qarkun Durrës); nr. 91, datë 27.05.2021 (për qarkun Tiranë); nr. 93, datë 31.05.2021 (për qarkun Korçë). Në të gjithë këto raste, subjekti zgjedhor Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim” (PD – AN) është paditës.

Në vijim, në datë 07.06.2021, ora 8:50, u regjistruan në Kolegjin zgjedhor :

- (i) Kërkesëpadia e subjektit zgjedhor Koalicioni PD – AN, për kundërshtimin e vendimit nr. 95, datë 31.05.2021 të KAS për zgjedhjet në qarkun Fier;
- (ii) Kërkesëpadia e subjektit zgjedhor Koalicioni PD – AN, për kundërshtimin e vendimit nr. 94, datë 31.05.2021 të KAS për zgjedhjet në qarkun Elbasan.

Kolegji Zgjedhor caktoi datën 08.06.2021, ora 9:00 dhe 9:15, për organizimin e shortit për caktimin e trupave gjykues për dy kërkesëpaditë e sipërcituara.

Po në datë 07.06.2021, ora 12.40, u depozitua në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor kërkesa e subjektit zgjedhor Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim” (PD – AN), me objekt *“Përrjashtimi nga gjykimi i padive të paraqitura nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim i shtatë gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor”*.

PRETENDIMET E KËRKUESIT

Pas përfundimit të shqyrtimit të ankimeve pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Ankesave, Subjekti zgjedhor PD-AN ka paraqitur në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor nëntë kërkesëpadi, nga të cilat janë shqyrtuar tri të tilla (ankimet me objekt pavlefshmërinë dhe përsëritjen e zgjedhjeve për qarqet Gjirokastrë, Vlorë dhe Berat).

Duke pasur parasysh ngjashmërinë e kërkesave procedurale, lidhur me marrjen e provave pranë organeve të administratës publike, themelin e pretendimeve të ngritura në secilën prej padive, si dhe faktin se Kolegji përbëhet nga vetëm tetë gjyqtarë, vlerësohet se janë kushtet kur gjyqtarët kanë shfaqur mendim për çështjet dhe janë krijuar arsye serioze njëanshmërie, të cilat kanë cenuar besimin e palës paditëse për një proces të rregullt ligjor.

Në terma konkretë, subjekti zgjedhor PD – AN, u referohet vendimeve të ndërmjetme të marra nëçështjet e shqyrtuara, kur Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka refuzuar kërkesat për marrjen e provave pranë organeve të administratës publike, sikurse edhe vendimeve përfundimtare për rrëzimin e padive (në tri çështjet e përfunduara). Duke cituar secilën prej çështjeve të shqyrtuara, gjyqtarët që përbënin në çdo rast trupin gjykues, arsyetimin mbi të cilin ishte refuzuar kërkesa për marrjen e provave, parashtrohet se shtatë gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, Znj. Alma Kolgjoka, Z. Asim Vokshi, Znj. Emona Muci, Znj. Esmeralda Xhili, Z. Gentjan Medja, Znj. Manjola Xhaxho dhe Z. Sokol Ibi, kanë marrë pjesë të paktën një herë në gjykimet e sipërcituara.

Në rrethanat e mësipërme, si dhe duke referuar normat ligjore, kushtetuese dhe konventore të treguara në pjesën hyrëse të këtij vendimi, subjekti zgjedhor PD-AN, kërkon përjashtimin për të shtatë gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. Në aspektin procedural, kërkuesi parashtroi se kërkesa duhet shqyrtuar nga një trup gjykues i përbërë nga tre gjyqtarë të Gjykatës

Administrative të Apelit, nisur nga fakti se shtatë nga tetë gjyqtarë të Kolegjit Zgjedhor, janë subjekte të kërkesës dhe është absurde që ata të marrin vendim për veten e tyre. Sa i përket shkaqeve, për të cilat kërkohet përjashtimi i gjyqtarëve, kërkesa bazohet në këto argumente :

- (i) Paanësia e gjykatës si element i procesit të rregullt gjyqësor, në kuptim edhe të nenit 42 të Kushtetutës dhe praktikës së Gjykatës Kushtetuese, nuk garantohet në rrethanat kur të paktën një herë, secili nga gjyqtarët ka marrë vendim refuzues lidhur me kërkesat për marrjen e provave. Këto vendime bazohen gjithashtu në arsyetim të njëjtë, çka nuk garanton në vijim, një proces të paanshëm dhe të drejtë për kërkuesin si paditës.
- (ii) E drejta për proces të rregullt, garantohet gjithashtu nga neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, komponent i së cilës është edhe gjykimi nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Koncepti i paanësisë së gjykatës, trajtohet në vetë praktikën e GJEDNJ, si në aspektin subjektiv, ashtu edhe atë objektiv.
- (iii) Mbi bazën e parimeve kushtetuese dhe konventore, edhe në rafshin ligjor, përcaktohen rregullat që garantojnë gjykimin nga një gjykatë e paanshme (neni 151 i Kodit Zgjedhor dhe neni 72 i Kodit të Procedurës Civile). Nga ngjashmëria e kërkesave procedurale dhe pretendimeve të themelittë paraqitura nga PD-AN si paditëse, është e qartë se nëse gjyqtarët janë shprehur një, dy ose tre herë, me vendim për këto kërkesa të përsëritura, atëherë vendimi i tyre për paditë e tjera është i ditur. Kjo sepse tashmë gjyqtarët e kanë shprehur mendimin e tyre nëpërmjet vendimeve dhe shprehja e mendimit lidhur me çështjen në shqyrtim është një nga rastet tipike të njëanshmërisë së gjyqarit dhe rasteve kur ai duhet të japë dorëheqjen. Shtatë gjyqtarët e Kolegjit nuk mundën më, të garantojnë të drejtën e palës paditëse për një gjykim të paanshëm dhe të drejtë. E vetmja mënyrë mbetet përjashtimi i shtatë gjyqtarëve dhe zëvendësimi i tyre me gjyqtarë të tjerë.
- (iv) Në shqyrtimin e kërkesës duhet mbajtur në konsideratë edhe sensibiliteti që ka gjykimi në mënyrë të drejtë dhe të paanshme i padive të subjektit zgjedhor PD – AN. Një gjykim i tillë nuk i shërben vetëm palës paditëse, por më së pari i shërben drejtësisë së zgjedhjeve të 25 prillit, çka shkon përtej interesave të partive politike. Në këtë rast çështja duhet shqyrtuar duke konsideruar interesin publik, lidhur me procesin zgjedhor dhe shqyrtimin e ankimeve zgjedhore.

VLERËSIMI I KOLEGJIT ZGJEDHOR

Lidhur me kompetencën për shqyrtimin e kërkesës

Në nenin 151(3) të Kodit Zgjedhor, përcaktohet se :

“3. Përjashtimi i gjyqtarit nga gjykimi i çështjes bëhet nga Kolegji Zgjedhor. Të gjithë gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor vendosin së bashku për vlefshmërinë e kundërshtimit ndaj ndonjërit prej gjyqtarëve”

Kërkuesi parashtron se, meqë shtatë nga tetë gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor janë subjekte të kërkesës për përjashtim, atëherë kërkesa duhet të shqyrtohet nga një trup gjykues i Gjykatës Administrative të Apelit, pranë së cilës Kolegji ushtron veprimtarinë.

Kolegji Zgjedhor e gjen të pabazuar këtë qëndrim lidhur me trupën që shqyrton kërkesën, për sa kohë që Kodi Zgjedhor përcakton rregullin për këtë çështje. Prezumohet se trupa e përbërë nga të gjithë gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor garanton përgjegjshmërinë dhe drejtësinë në trajtimin e çdo kërkesë për përjashtim të gjyqtarit të tij. Po ashtu, mënyra se si ngrihet dhe funksionon Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, garanton pavarësinë e tij kundrejt çdo autoriteti tjetër, qoftë ky edhe gjyqësor.

Ajo që nga kërkuesi konceptohet si absurd (gjykimi i vetvetes), nuk përbën argument për të përligjur shmangien e gjyqtarëve të Kolegjit nga përgjegjësia, me të cilën ligji i ngarkon dhe, njëkohësisht, angazhimin e një strukture gjyqësore të paparashikuar me ligj për të shqyrtuar çështje, që lidhen me mosmarrëveshjet zgjedhore, ekskluzivisht në kompetencë të këtij Kolegji. Zgjedhja e posaçme që ka bërë Kodi Zgjedhor për kompetencën e gjykatës për shqyrtimin e kërkesës për përjashtim (ndaj një apo më shumë gjyqtarëve), është shprehje e garantimit të pavarësisë së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në ushtrimin e funksioneve të veta.

Duke qëndruar në zgjidhjen, që ligji parashikon, për trajtimin e kërkesave eventuale për përjashtim të gjyqtarit/gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor, në mungesë të një alternative të ndryshme, trupa gjyqësore me përbërje të tetë gjyqtarët e Kolegjit, është i vetmi autoritet i ngarkuar nga ligji, që duhet të shqyrtojë edhe në rastin konkret, pretendimin e kërkuesit për mungesën e paanësisë së gjyqtarëve. Në këtë vlerësim, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, i referohet edhe praktikës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e cila në rastin e shqyrtimit

të çështjes së njohur si ligji për lustracionin/pastërtinë e figurës, shqyrtoi vetë kërkesën për përjashtim të disa gjyqtarëve të saj, për të cilët u pretendua mungesë paanësie (*vendimi nr. 9/2010 i Gjykatës Kushtetuese*).

Si përfundim, kërkesa për përjashtim shqyrtohet nga mbledhja e të gjithë gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, si gjykata e caktuar me ligj dhe kjo është në pajtim të plotë me respektimin e parimit të pavarësisë së gjyqësorit.

Lidhur me themelin e pretendimit për përjashtimin e gjyqtarëve

Sikurse parashtrohet më sipër në këtë vendim, marrja e vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare për disa mosmarrëveshje zgjedhore, konsiderohet nga kërkuesi si shkak për përjashtimin e gjyqtarit, referuar për këtë ngjashmëri të kërkesave procedurale dhe pretendimeve thelbësore, në të gjitha mosmarrëveshjet, përfshirë edhe ato që priten të gjykohen.

Nisur nga përbërjet e trupave gjykues të shortuar deri në këtë fazë të procesit të shqyrtimit të ankimeve zgjedhore, shtatë nga tetë anëtarët e Kolegjit Zgjedhor kanë marrë pjesë dhe kanë vendosur, si për kërkesat e palëve përgjatë procesit gjyqësor, sikurse janë edhe kërkesat për marrjen e provave, ashtu edhe për themelin e padive përkatëse.

Referuar fakteve të mësipërme, shtrohet për diskutim çështja nëse dhënia e vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare për çështje të caktuara, a përbën shkak për përjashtimin e gjyqtarit/gjyqtarëve, nga gjykimi i çështjeve të mëvonshme, qofshin këto edhe të ngjashme për nga natyra e kërkimeve që mbartin?

Kolegji Gjyqësor Zgjedhor evidenton se e drejta për tu gjykuar nga një gjykatë e pavaruar dhe e paanshme, përbën një nga komponentët më të rëndësishëm të procesit të rregullt gjyqësor. Aktet ndërkombëtare dhe e drejta e brendshme, garantojnë respektimin e kësaj të drejte themelore. Po ashtu, në aspektin e brendshëm evidentohet një jurisprudencë e pasur e Gjykatës Kushtetuese, e cila ka analizuar nocionin e gjykatës së paanshme, si element i procesit të rregullt gjyqësor.

Gjykata Kushtetuese, nën frymën edhe të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i

KEDNJ-së. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimin nr. 6, datë 16.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjyqtari është personalisht i paanshëm, derisa njëra nga palët, gjatë rrjedhës së procesit, të mos ngrejë prova për të kundërtën. Paanshmëria nënkupton që gjyqtarët nuk duhet të fshehin paragjykime rreth çështjes të vënë përpara tyre dhe se ata duhet të mos veprojnë në mënyra që nxisin interesat e njëres palë. Gjyqësori kërkohet të sigurojë që procedurat të drejtohen ndershmërisht e drejtësisht dhe që të respektohen të drejtat e të gjitha palëve. Paanshmëria e vërtetë dhe të hequrit si i paanshëm janë që të dyja themelore për ruajtjen e respektit ndaj drejtësisë.

Parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata duhet të jetë e kujdesshme dhe të marrë parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohej nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv (*shih vendimin nr. 36, datë 26.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

Jurisprudenca e deritanishme e Gjykatës Kushtetuese ka evidentuar se ky parim duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit. Për Gjykatën është konsideruar “gjykatë e njëanshme” trupi gjykues, në përbërje të të cilit ka qenë i pranishëm qoftë edhe vetëm një gjyqtar, i cili, në këndvështrimin objektiv, nuk jepte garanci për një gjykim të paanshëm. Gjykata ka theksuar se thjesht dhe vetëm pjesëmarrja e një ose më shumë gjyqtarëve në një procedim të mëparshëm, pavarësisht nga ndikimi i pranisë dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues, është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkuesin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e çështjes së tij (*shih vendimin nr. 49, datë 10.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, respektimi i parimit të paanshmërisë verifikohet duke zbatuar dy teste: testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit që bindja personale ose interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës, si edhe testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme mund të ketë një farë rëndësie. Për rrjedhojë, kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm (*shih vendimin nr. 49, datë 10.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

Me qëllim garantimin e paanshmërisë së gjykatës, ligji ka parashikuar rastet, kur gjyqtari i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësorështë i detyruar të japë dorëheqjen, apo të përjashtohet. Sipas nenit 151.2 të Kodit Zgjedhor, përjashtimi i gjyqtarit të Kolegjit Zgjedhor bëhet nëse : (i) gjyqtari ka ndonjë interes për çështjen, (ii) ka qenë më parë punëdhënës, punëmarrës, këshilltar, përfaqësues ose avokat i ndonjërës prej palëve, (iii) ka lidhje gjinie ose marrëdhënie krushqie të afërt me ndonjë nga palët, (iv) rezulton se ai nuk mund ta kryejë detyrën në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe pa favorizuar asnjë prej palëve. Ky parashikim ligjor, i ngjashëm me rregullime të tjera si në ligjet procedurale civile, penale a administrative, por edhe më tej kur synohet paanshmëria e një trupe gjykuese, mbart në vetvete edhe specifikën e trupës së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, e cila përbëhet nga vetëm tetë anëtarë, të zgjedhur për një afat të caktuar, nëpërmjet shortit. Asnjë gjyqtar tjetër i Republikës së Shqipërisë, që nuk është përzgjedhur sipas kësaj procedure, nuk mund të shqyrtojë çështjet e përcaktuara nëkompetencë të Kolegjit Zgjedhor. Kjo do të thotë që mosmarrëveshjet lidhur me një proces zgjedhor, do të shqyrtohen detyrimisht nga gjyqtarë të Kolegjit Zgjedhor, duke mos pasur asnjë alternativë tjetër, si dhe duke i përcaktuar ata rast pas rasti nëpërmjet shortit. Për rrjedhojë edhe çështjet, që lidhen me përbërjen e gjykatës dhe garancitë që ofron ajo në drejtim të paanshmërisë së saj, do të trajtohen sipas këtij rregullimi tëposaçëm, qëprevalonkundrejt rregullimeve të tjera ligjore (*lexspecialisderogatgenerali*).

Kodi Zgjedhor, si edhe rregullime të tjera të ngjashme, synojnë në vetvete të mbrojnë autoritetin e gjykatës dhe besimin e publikut në drejtësinë zgjedhore, ndaj rrethana të tilla që lidhen me

arsye serioze dhe bindëse që vënë në dyshim paanësinë e gjyqtarit të Kolegjit Zgjedhor, duhet të jenë të mjaftueshme, për të dhënë dorëheqjen/për tu përjashtuar. Nga ana tjetër, Kolegji Zgjedhor ka detyrimin ligjor të marrë përsipër dhe ushtrojë përgjegjësitë e ngarkuara me ligj, për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve zgjedhore, duke shmangur kështu çdo situatë që do të çonte në pamundësi absolute për vendimmarrje. I tillë është edhe rasti në shqyrtim kur kërkohet përjashtimi në bllok i shtatë gjyqtarëve të këtij Kolegji, mbi arsyetimin se kanë shqyrtuar dhe dhënë vendime për mosmarrëveshjet e mëparshme zgjedhore, që nuk janë mirëpritur nga kërkuesi. Për rrjedhojë mungesa e një parashikimi të shprehur në Kodin Zgjedhor, lidhur me përjashtimin e gjyqtarit, kur ai më parë ka shqyrtuar një tjetër mosmarrëveshje, duhet kuptuar dhe interpretuar si një zgjidhje e ligjit, që shmang bllokimin e vetë gjykatës dhe pamundësinë e kontrollit gjyqësor mbi çështjet zgjedhore. Në këtë kuptim pretendimi i kërkuesit për përjashtimin e gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor, bazuar në faktin se më herët ata shqyrtuan dhe dhanë vendime të ndërmjetme dhe përfundimtare për çështje të ngjashme, me ato që priten të shqyrtohen, duhet vlerësuar në mënyrë të tillë që të garantojë jo vetëm paanësinë e gjykatës, por edhe vetëekzistencën e saj. Pa një gjykatë zgjedhore, nuk garantohet as kontrolli gjyqësor mbi procesin zgjedhor, çka është e rrezikshme për vetëintegritetin e procesit zgjedhor dhe demokracinë.

Komisioni i Venecias me Opinionin Amicus Curiae nr. 524/2009 (miratuar në Sesionin Plenar të 80-të), i kërkuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në rastin e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së ligjit për pastërtinë e figurës, trajtoi edhe çështjen, që lidhej me vënien në diskutim të paanësisë së disa gjyqtarëve, me pasojë eventuale bllokimin e vetë Gjykatës. Ndër të tjera, duke vënë në pah rëndësinë që paraqet paanësia e gjykatës në një shoqëri demokratike, Komisioni i Venecias parashtron se:

“... 140. Nëse përjashtimi i gjyqtarëve çon në mosarritjen e kuorumit të nevojshëm nga Gjykata, ajo do të bllokohet të vendosë mbi kushtetueshmërinë e ligjit për Lustracionin. Zgjidhja për këtë problem do të duhet të mbështetet si në vlerësimin e rëndësisë që ka paanëshmëria e gjyqtarëve, ashtu edhe në nevojën për kontrollin e akteve të parlamentit nga Gjykata Kushtetuese.

...

143. Për sa i takon vendimet për ndërprerjen e mandateve të institucioneve kushtetuese, nuk ka hapësirë veprimi. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese janë anëtarë të një prej institucioneve të mbrojtura nga Kushtetuta. Kështu, ligji për Lustracionin vjen në kundërshtim të qartë me Kushtetutën (shih më lart, paragrafet 68, 74 dhe 74). Të vendosësh për antikushtetutshmërinë e dispozitës përkatëse të ligjit për Lustracionin nuk është një çështje e diskrecionit apo e gjykimit personal. Për këtë arsye, një paragjykim i mundshëm i njëanshmërisë së gjyqtarit nuk mund të ndikojë në vendimin e tij. Si rrjedhojë, nuk ka prova për njëanshmëri të theksuara. Gjyqtari nuk është i detyruar të tërhiqet nga gjykimi; Gjykata nuk ka të drejtë ta përjashtojë atë, nëse ai nuk do të tërhiqet me vullnetin e tij të lirë. Në një situatë të tillë, qëllimi për të shmangur një situatë në të cilën Gjykata do të bllokohej nga kontrolli mbi ligjin është superior ndaj çdo interesi tjetër të përfshirë (shih *mutatismutandis Komisioni i Venecias, Opinion mbi dy projekt-ligje për të ndryshuar Ligjin nr.47/1992 mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Rumanisë, CDL-AD (2006) 006, § 7*).”

Në kërkesën objekt shqyrtimi kërkuesi vë në dyshim paanësinë e gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor, bazuar nëfakte, që lidhen me ushtrimin prej tyre të detyrës në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve zgjedhore. Qartazi konstatohet se mbi gjyqtarët nuk ka asnjë pretendim për konflikt interesi, duke referuar si shkak përjashtimi marrjen prej tyre të vendimeve të mëparshme për mosmarrëveshje zgjedhore, që sipas kërkuetit janë të ngjashme për nga natyra e kërkimeve. Është pikërisht ushtrimi i funksionit gjyqësor, në përmbushje të përgjegjësisive ligjore, baza mbi të cilën kërkohet përjashtimi i gjyqtarëve, për arsye se vendimet e dhëna nuk kanë qenë të mirëpritura nga kërkuesi/paditës. Nisur nga këto rrethana, Kolegji Zgjedhor vlerëson se mungojnë arsye serioze për të besuar se paanësia e gjyqtarëve në gjykimet e ardhshme është e rrezikuar, për sa kohë që nuk rezulton që të evidentohen interesa apo gjykime personale për asnjë prej tyre.

Mbledhja e anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor vëren se nuk mund të ketë kërkesën *abstracto* për përjashtimin e disa gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, por çdo kërkesë duhet parashtruar vetëm brenda një çështje të caktuar zgjedhore, për gjyqtarët e asaj çështje. Nuk mund të kërkohet përjashtimi i gjykatës si e tërë. Për më tepër, pretendimi se, meqë kërkuesi nuk është i kënaqur me vendimmarrjet e mëparshme të gjykatës, atëherë duhet të përjashtohen të gjithë anëtarët e gjykatës që kanë marrë pjesë në ato vendimmarrje, është në vetvete i gabuar, i paarsyeshëm dhe kundërshtim me parimin e pavarësisë dhe paanësisë së gjyqtarëve. Gjyqtari ka

detyrimin të gjykojë me mendje të hapur çdo çështje që i paraqitet për zgjidhje dhe referimi në praktikën e mëparshme (*kur është rasti*) jo vetëm nuk e bën gjyqtarin të anshëm për atë çështje, por përkundrazi është shprehja më e lartë e zbatimit të parimit të sigurisë ligjore. Në lidhje me këtë vlen të përmendet se në çështjen Gjon Boçarik. Shqipërisë (*Ankimi NR. 10508/02*) Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut është shprehur se: *“Lidhur me paanësinë objektive, gjykata tashmë ka konkluduar se fakti i thjeshtë që gjyqtari ka marrë vendim, në vetvete nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanësisë së tij. Ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që kryen ai gjatë procesit gjyqësor. Në të njëjtën mënyrë, njohuritë e detajuara të gjyqtarit mbi çështjen, nuk përbëjnë ndonjë shkak për të dyshuar mbi paanshmërinë e tij gjatë marrjes së vendimit në themel.”*

Po ashtu, sa i përket parimit të paanësisë së gjyqtarit në lidhje natyrën e pretendimit të kërkuarit për vendimmarrjet e mëparshme të gjyqtarëve, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor mban parasysht konceptualisht edhe jurisprudencën e gjykatave me reputacion të lartë ndërkombëtar për standarde ligjore, siç është edhe Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila në vendimin e dhënë prej saj në çështjen *Liteky et alk. Shteteve të Bashkuara të Amerikës* [510 U. S. 540 (1994)], ka shfaqur një kuptim me këmbë në tokë, të parimit të paanësisë së gjyqtarit. Konkretisht në këtë çështje, Gjykata Supreme shprehet se: *“Ashtu siç gjyqtari Jerome Frank ka theksuar me forcë: “Paanshmëria nuk është naivitet. Mos-interesimi nuk duhet barazuar me pafajësinë e një fëmije. Nëse gjyqtari nuk formon gjykime për aktorët e të ashtuquajturave drama gjyqësore që zhvillohen në gjykatë, ai nuk do të mundet kurrë të marrë një vendim.”* Në këtë vendim, përcaktohet edhe se: *“Së pari, vendimet e gjykatës në vetvete, pothuajse asnjëherë nuk përbëjnë bazë të vlefshme për pretendimet e paragjyqimit apo anshmërisë së gjyqtarit [...] Së dyti, mendimet që formon gjyqtari në bazë të fakteve apo ngjarjeve që verifikohen apo ndodhin gjatë procesit, apo para tij, nuk përbëjnë bazë për pretendime për paragjykim apo anshmëri, përveç nëse ato nxjerrin në pah një favorizim apo antagonizëm të rrënjosur thellë, që mund të bëjë të pamundur gjykimin e ndershëm të çështjes.”*

Në lidhje me sa më sipër, mbledhja e gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor thekson se mosmarrëveshjet zgjedhore dhe referimi i tyre në rrugë gjyqësore rregullohet me ligj, ndërsa shkaqet dhe pretendimet konkrete parashtrihen nga palët në proces, të pandikuara në asnjë rast nga gjykata që e shqyrton çështjen. Ngjashmëria mes çështjeve të ndryshme mbetet e diskutueshme dhe nëçdo rast ajo nuk diktohet nga gjykata. Kjo e fundit ka detyrimin ligjor të japë vendime mbi sa i kërkohet, sikurse ka ndodhur edhe në këtë proces të shqyrtimit të ankimeve

zgjedhore në rrugë gjyqësore. Po ashtu, gjykata ka objektivisht detyrimin ligjor të zgjidhë në mënyrë të njëjtëçështje të ngjashme, çka garanton sigurinë juridike për palët në proces. Vazhdimësia e praktikës gjyqësore përbën detyrim për gjykatën, ashtu sikurse nuk përjashtohet mundësia e evoluimit të saj, nëpërmjet konkluzioneve të reja mbi interpretimin e ligjit, nëse ekzistojnë arsye të forta, që justifikojnë ndryshimin e praktikës dhe që e bëjnë atë (ndryshimin) të domosdoshëm objektivisht. Për rrjedhojë vënia në diskutim e paanësisë së gjyqtarëve, mbi argumentin se kanë zgjidhur çështje në ngjashme, nuk përbën arsye serioze njëanshmërie. Gjyqtari i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në përmbushjen e detyrës së tij, i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit, ndaj ushtrimi në mënyrë të pavarur i pushtetit gjyqësor, nuk mund të jetë në asnjë rast argument i mjaftueshëm për ta përjashtuar atë nga veprimtaria e mëtejshme gjyqësore, pavarësisht se vendimet e dhëna nuk janë tësuksesshëm për kërkimet e një ose disa subjekte. Një qëndrim i ndryshëm mbi këtëçështje, do të sillte për pasojë, si vënien nën presion të gjykatës, ashtu edhe pamundësinë e Kolegjit për të ushtruar detyrën e ngarkuar nga ligji.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në nenin 158, pika 3 të Kodit Zgjedhor

V E N D O S I

- Rrëzimin e kërkesës së subjektit zgjedhor Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim” për përjashtimin e gjyqtarëve Znj. Manjola Xhaxho, Z. Gentjan Medja, Z. Sokol Ibi, Znj. Alma Kolgjoka, Znj. Emona Muci, Znj. Esmeralda Xhili (Ceka) dhe Z. Asim Vokshi.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall në Tiranë, në datë 08.06.2021.

GJYQTARE

GJYQTARE GJYQTARE

Emona MUÇI Alma KOLGJOKA

Edlira PETRI

GJYQTAREGJYQTARGJYQTAR

Esmeralda ÇEKA (XHILI)

Gentian MEDJA

Sokol IBI

GJYQTAR

GJYQTARE

Asim VOKSHI

Manjola XHAXHO